

Tregu i sigurimeve dhe fondi i kompensimit

Ka ditë që në shtyp po flitet për tregun e sigurimeve, për primet e sigurimeve, pagesën e dëmeve, raportet prime-dëme, fondin e kompensimit, vendimet arbitrare të gjykatave etj. Natyrisht, logjika e kësaj zhurme mediatike është e qartë për vetë pjesën që zënë sigurimet motorike në totalin e sigurimeve në Shqipëri.

Nga ana tjetër, shqetësimi duket i drejtë edhe nga fakti se ka të bëjë me një produkt të njohur, të përditshëm dhe një produkt që në fund të fundit e kërkon Policia, e cila e ka edhe detyrim ligjor të kontrollojë drejtuesit e mjeteve, nëse janë apo jo të pajisur me këtë lloj siguracioni. Sikurse është thënë edhe më parë, në situata apo diskutime të ngjashme, një faktor i rëndësishëm është mungesa e kulturës së sigurimeve dhe fuqia e këtij tregu, jo në rëndësinë që duhet të ketë, por në rëndësinë që ka aktualisht.

Megjithatë, pavarësisht rëndësisë që ka ky sigurim, e rëndësishme është se sa të ndërgjegjshëm janë qytetarët shqiptarë për të pasur këtë lloj sigurimi, sa i rëndësishëm është ai për çdo drejtues automjeti dhe a është sigurimi TPL një mbrojtje e rëndësishme financiare për drejtuesin e mjetit?

Primi i sigurimeve në fund të fundit shpreh garantimin e pagesës së dëmeve; sa më i ulët të jetë ai, aq më e rrezikuar është pagesa e dëmeve. Por që në fund të fundit, ato janë të garantuara në pagesën e dëmit nëse kanë në dorë një polisë sigurimi. Përgjegjësia bie në fund të fundit mbi kompaninë dhe në mënyrë të veçantë mbi aksionerët e kompanive, të cilët nga dita në ditë jo vetëm që nuk po realizojnë fitime, por po rriskojnë edhe kapitalet e tyre.

Primi i sigurimit është njëra anë dhe, duke qenë i tillë, ai ka dhe vlerën ligjore; Por nga ana tjetër, një numër i madh mjeteve qarkullojnë të pasiguruara, të cilat me aksidentet e shkaktuara kanë krijuar një shqetësim të madh në treg dhe shqetësimin më të madh vetes së tyre, pasi janë të detyruar në bazë të ligjit të kthejnë shumat e paguara për klientë të dëmtuar byrosë shqiptare të sigurimeve.

Sigurimi motorik ose TPL është sigurim i detyrueshëm në të gjithë botën dhe mund të themi se është një nga sigurimet më problematike. Ky lloj sigurimi ngarkon në shumë raste siguruesit me përgjegjësi të mëdha financiare për shkak të gabimeve të drejtuesve të automjeteve. Megjithatë, jo rrallë edhe të pasiguarit janë detyruar të paguajnë miliona euro dhe ndoshta t'i shkaktojnë falimentime të shoqërisë

së tyre dhe individëve. Vlerat më të mëdha të paguara për shkak të një aksidenti automobilistik kanë kaluar edhe qindra miliona euro.

Efekti i këtij sigurimi është i madh dhe një nga mbrojtësit e përgjegjësive financiare të drejtuesve të mjeteve. Në këta 20 vjet të ekzistencës së industrisë private të sigurimeve në Shqipëri, janë paguar mbi 300 milionë euro dëme të shkaktuara nga drejtuesit e mjeteve motorike, të cilat përfshijnë dëme materiale, shëndetësore dhe dëme të tjera të shkaktuara si rezultat i aksidenteve.

Pra, janë shifra të mëdha dhe që natyrisht duhen marrë në konsideratë dhe duhen vlerësuar si të tilla. Por shqetësimi është në një këndvështrim tjetër: janë evidentuar dhe paguar dëme të shkaktuara nga mjete të pasiguruar, të cilat vetëm për 10 vitet e fundit kapin vlerën mbi 10 milionë euro, vlerë kjo e cila, në fund të fundit, është përgjegjësi e shkaktarëve të dëmeve.

Gjykatat kanë shpallur vendime për byronë e sigurimit, duke mos thërritur shkaktarët e dëmeve në Gjykatë, për të cilat ato janë përgjegjës që në fund të fundit do paguajnë dëmin dhe byroja është garantuese e pagesës së dëmit e, ndonjëherë edhe policia e qarkullimit rrugor, segmente të Prokurorisë dhe instrumente të tjera kanë krijuar precedentin negativ, duke rënduar shumë ashpër personat e pasiguruar, shkaktarë të dëmeve me vlera dëmsh shumë të mëdha duke i rritur ato artificialisht, duke menduar se do paguajë byroja e sigurimeve dhe duke harruar se paguesi i fundit do jetë shaktari i dëmit të pasiguruar.

Si rezultat, sot është krijuar një shqetësim i madh, pasi shumë familje, prindër apo persona të tjerë kanë sot mbi vete përgjegjësi të mëdha financiare, përveç asaj që kanë kaluar nëpër organet gjyqësore apo dënimeve me heqje lirie. Në këtë mënyrë, tani janë të detyruar të dëmshpërblejnë jo vetëm viktimën, por edhe gjykatësin, avokatin, ekspertin e dëmit, duke trefishuar apo katërfishuar vlerën reale të dëmit të shkaktuar.

Për rrjedhojë, çështja e cila duhet diskutuar gjerësisht, është se sa të përgjegjshëm janë qytetarët në lidhje me pagesën e këtij siguracioni dhe sa të kushton mungesa e tij.

Ligji e ka përcaktuar qartë se çdo drejtues automjeti dhe çdo automjet duhet të qarkullojë i pajisur me siguracion. Ky kusht është i theksuar në ligj, në të cilin janë përcaktuar qartë edhe përgjegjësitë që rrjedhin në rast se je i pasiguruar. Aktualisht në territorin e Shqipërisë ndodhin çdo ditë mbi 50 aksidente, si rezultat i të cilave shkaktohen herë vetëm dëme materiale e herë edhe dëme shëndetësore dhe, fatkeqësisht, në jo pak raste shkaktohen edhe vdekje.

Të gjitha këto dëme kanë si pasojë përgjegjësinë financiare, të cilën duhet ta paguajnë kompanitë e sigurimit dhe fakti është që kjo përgjegjësi në tërësi paguhet. Por çfarë do të ndodhte nëse do të kishim gjithë këto aksidente dhe nuk do të kishim siguracione?

Në këtë rast lindin dy përgjegjësi të tjera: përgjegjësia sociale ku konflikti social do rritej hap pas hapi dhe çdo ditë e më shumë vetëgjyqësia do të bëhej pjesë e mbrapshtë e jetës sonë. Së dyti, do të kishim përgjegjësi financiare për të cilat konfliktet sociale do të rriteshin dhe do të paguhej dëmi i shkaktuar. Zbatimi i ligjit në sigurimin e automjeteve nuk ka efektin e duhur, së pari për shkak të përgjegjësive individuale dhe mungesës së kulturës dhe, së dyti, nga mungesa e kontrollit nga ana e Policisë rrugore, e cila e ka detyrimin të bëjë këtë lloj kontrolli në zbatim të ligjit.

Normalisht, ligji u ka dhënë mundësinë e kompensimit të dëmeve edhe të pasiguruarve, të cilët mund të jenë shkaktarë apo të dëmtuar nga aksidentet. Më specifikisht, sipas statistikave, 25% e drejtuesve të mjeteve janë të pasiguruar dhe një pjesë e tyre janë shkaktarë të aksidenteve. Pra, këtu kemi të bëjmë me çështje që jo vetëm rëndojnë të dëmtuarit nga aksidentet, por gjithashtu për shkak të procedurave që ekzistojnë, të dëmtuarit janë dëmshpërblyer me vonesë ose janë bërë objekt i gjykimit në Gjykatë.

Këta të dëmtuar nga automjete të pasiguruara kanë të drejtën morale dhe gjyqësore të paguhet nga ajo pjesë e një fondi të krijuar posaçërisht për të përballuar dëmin apo dhimbjen për dëmin e shkaktuar nga mjetet e pasiguruara.

Me pak fjalë, ligji ua jep të drejtën e pagesës së dëmit, por nga ana tjetër personi i pasiguruar do të paguajë me padi regresi të gjithë shumën që ka përfituar nga aksidenti mbi bazën e vlerës së dëmit, marrëveshjes së pranimit të vlerës së dëmit apo vendimit të gjykatës.

Dëmet e paguara nga Byroja Shqiptare e Sigurimit deri më sot janë mbi 10.5 milionë euro, vlerë kjo e cila do të paguhet nga drejtuesit e automjeteve, të cilët kanë shkaktuar këto dëme që përfituesit më të mëdhenj janë avokatët dhe gjithë të korruptuarit me fatkeqësinë e tjetrit, i cili në momentin e aksidentit ka qenë i pasiguruar.

Byroja Shqiptare e Sigurimit është garantuese e pagesës dhe natyrisht me padi regresi i drejtohet shkaktarit për të paguar vlerën e dëmit.